



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 906 Prot.

Tiranë, më 03._08.2023

V E N D I M

Nr. 153 , datë 03._08.2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 128 Regj, datë 07.09.2022, paraqitur nga znj.E.S, e përfaqësuar nga Shoqata “*Për Drejtësi Sociale*”, me Kryetar G.S, kundër Bashkisë Korçë, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*etnisë*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, rezulton se, ankuesja E.S, e cila i përket pakicës kombëtare egjiptiane të qytetit të Korçës, ka përfunduar studimet Bachelor në Fakultetin e Gjuhë-Letërsisë, si dhe në programin Master Profesional në këtë degë me profil *Minor Arte*, pranë Universitetit Fan S. Noli në Korçë. Znj. S. shprehet se ka 9 vite eksperiencë pune pranë disa organizatave të mëdha të tilla si: RVA, Disutni Albani, Soros, UNDP, Unë Gruaja etj., në të cilat ka dhënë kontributin e saj për përmirësimin e jetës së qytetarëve në Shqipëri, si dhe është në dijeni në lidhje me problematikat dhe çështjet që kanë nevojë për përmirësim lidhur me informimin e qytetarëve.

Mbështetur në sa më sipër, në datën 20.07.2022 ankuesja E.S ka aplikuar për pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive, në pozicionin “specialist” në Sektorin e Informimit Qytetar, pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimin Qytetar, të Bashkisë Korçë, i cili është shpallur vakant nga ana e këtij institucioni në muajin korrik 2022.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Për sa më sipër, ankuesja shprehet se ka marrë pjesë në konkurrim për këtë pozicion pune në të gjitha fazat e tij, përfshirë këtu edhe në intervistën me gojë. Në përfundim të konkurrimit, nëpërmjet *e-mailit* të datës 26.08.2022, ajo sqaron se është njoftuar nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Korçë se nuk është përzgjedhur kandidatë fituese me mbi 70 pikë (70% të pikëve). Gjithashtu ky institucion e ka njoftuar znj. S. mbi vlerësimin e saj, i cili ka qenë 39.5 pikë nga 60 pikë të mundshme, në provimin me shkrim; 1 pikë nga 15 pikë të mundshme për jetëshkrimin e saj; 20 pikë nga 25 pikë të mundshme në intervistën me gojë. Për sa më sipër, rezulton se ankuesja është vlerësuar në total me 60.5 pikë nga 100 pikë të mundshme.

Znj. S. shprehet se e ka ankimuar vlerësimin e sipërcituar dhe ka paraqitur ankesë me shkrim dhe *e-mail* brenda afateve ligjore pranë Bashkisë Korçë. Znj. S. sqaron se Bashkia Korçë ka kryer shkelje ligjore dhe se ajo nuk është vlerësuar saktë në konkursin e sipërcituar.

Ajo thekson faktin se është i papranueshëm fakti që jetëshkrimi i saj është vlerësuar me 1 (një) pikë. Në bazë të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015 "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*" ku parashikohet se: "*Nëse kandidati grumbullon mbi 45 pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë*", vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve të lidhura me fushën. Ankuesja pretendon se vlerësimi i kryer ndaj saj është i qëllimtë, për ta skualifikuar, pasi jetëshkrimi i saj nuk mund të vlerësohej me kaq pak pikë.

Njëkohësisht, në ankesën e saj, znj. S. ka vënë në dukje faktin se në pikën 11, të Kreut IV, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015 "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*" parashikohet se: "*Nëse kandidati grumbullon mbi 45 pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë*". Referuar vlerësimit të paraqitur në shkresën për njoftim me përgjigjen përfundimtare të Bashkisë Korçë rezulton se znj. S. ka përfituar vetëm 40.5 pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku. Pavarësisht nga vlerësimi i mësipërm, ku ankuesja ka fituar me pak se 45 pikë në vlerësimin me shkrim dhe në jetëshkrim, rezulton se ajo është pranuar në intervistën e strukturuar me gojë edhe pa patur pikët e nevojshme për t'u kualifikuar. Në këto kushte, ankuesja hedh dyshimin e saj për mosvlerësim të saktë të saj gjatë fazave të konkurrimit, sidomos për sa i përket jetëshkrimit, duke menduar se procesi përzgjedhës i fituesit ka qenë fiktiv dhe ai ka qenë i paracaktuar. Në këtë kontekst, pala ankuese pretendon se procedura e ndjekur nga ana e strukturës përkatëse ka qenë në shkelje të ligjit dhe diskriminuese ndaj saj, për shkak të përkatësisë etnike.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t'a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Kjo dispozitë i jep të

drejtën Komisionerit për të shqyrtuar, ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm në dy situata të veçanta. Në rastin e parë, organizata me interesa legjitime mund të paraqes ankesë pranë Komisionerit në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi dhe në rastin e dytë, organizata me interesa legjitime mund të paraqes ankesë pranë Komisionerit për çështje që lidhen me interesin publik. Në të dy këto raste organizata me interesa legjitime, nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin.

Në rastin e parë kemi të bëjmë me një ankesë individuale pavarësisht se organizata me interesa legjitime, legjitimohet në cilësinë e palës/subjektit që mund të vërë në lëvizje Komisionerin për të filluar një procedurë administrative. Kushti që organizata me interesa legjitime duhet të plotësojë për tu legjitimuar si palë përpara Komisionerit, është fakti se duhet të jetë e pajisur me pëlqimin me shkrim të personit i cili pretendon se është diskriminuar.

Në rastin e dytë kemi të bëjmë me një ankesë të natyrës kolektive, ku interesi legjitim i cënuar, i cili synohet të rivendoset nëpërmjet fillimit të procedurës administrative pranë Komisionerit, nuk është individual por është një interes kolektiv. Në këtë rast që organizata me interesa legjitime, të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cënohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.”*

Nga aktet e administruara rezulton se, Shoqata “Për Drejtësi Sociale” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr. 6599, datë 14.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, konstatohet se Shoqata “Për drejtësi sociale”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin për të respektuar, promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore, në mënyrë që, pavarësisht dallimeve sociale, ekonomike, racore, ideologjike, krahinore identitetit gjinor, apo çdo aspekti tjetër, të mund të ushtrojnë lirisht të drejtat dhe liritë e tyre themelore dhe të aksesojnë në mënyrë të barabartë shërbimet publike. Në mënyrë të veçantë objekti i veprimtarisë së kësaj organizate konsiston në advokimin, mbrojtjen në mënyrë proaktive dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri.

Bazuar në ankesën e paraqitur Shoqata “Për Drejtësi Sociale” nuk pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, nuk pretendon cënim të një interesave kolektive, por pretendon diskriminim në emër dhe për llogari të znj. E.S. Në bazë të akteve të administruara rezulton se, znj. E.S, e cila pretendon se është diskriminuar dhe në emër të të cilës, Shoqata “Për

Drejtësi Sociale”, ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi ka dhënë pëlqimin e saj me shkrim për paraqitjen e kësaj ankese dhe përfaqësimin nga ana e kësaj shoqate. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Shoqata “Për Drejtësi Sociale”, legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi para Komisionerit, në emër të znj. E.S.

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh dhe përcakton shprehimisht si shkak të mbrojtur shkakun e etnisë të pretenduar nga pala ankuese, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1205/1 Prot., datë 12.09.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion në lidhje me ankesën, nga Bashkia Korçë në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Me shkresën nr.7769/1 prot., datë 22.09.2022, Bashkia Korçë, ktheu përgjigje duke informuar Komisionerin, ndër të tjera se:

“.....**Së pari**, ankuesja znj. E.S ka depozituar dokumentat e saj për konkursin e zhvilluar “specialist në sektorin e informimit qytetar”. Znj. E.S ka zhvilluar provimin me shkrim dhe intervistën dhe në përfundim të fazave të konkursit është vlerësuar me 60.5 pikë nga 100 pikë në total. Në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar, si dhe Kreu IV i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” kandidatja ka marrë më pak se 70 pikë dhe për këtë arsye nuk është përzgjedhur

si kandidat fitues. **Së dyti**, për këtë pozicion pune kanë aplikuar katër kandidatë, prej të cilëve një është skualifikuar në fazën e verifikimit paraprak për shkak të mungesës së dokumentacionit , më pas një kandidat është skualifikuar për shkak se në provimin me shkrim nuk ka marrë pikët e mjaftueshme për kualifikimin në fazën e intervistës dhe së fundmi dy kandidatë kanë zhvilluar testimin me shkrim dhe intervistën por nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme për kualifikimin e tyre si kandidatë fitues, pra kanë marrë më pak se 70 pikë. **Së treti**, në lidhje me informacionin mbi numrin e kandidatëve që i përkasin pakicave kombëtare, nuk kemi informacion, pasi këto të dhëna sensitive nuk kërkohen nga ana jonë. Theksojmë se konkurset për pranimin në shërbimin civil bazohen në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet një konkurrimi kombëtar, që përfshin një testim të shkruar, një testim me gojë dhe cdo formë tjetër të përshtatshme të verifikimit të aftësive, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatit. **Së katërti**, janë skualifikuar dy kandidatë të cilët kanë marrë më pak se 70 pikë (duke përfshirë dhe ankuesen). **Së pesti**, ju sqarojmë për konkursin në fjalë nuk kemi kandidat fitues. **Së gjashti**, nuk kemi ankesa nga kandidatët e tjerë të cilët janë skualifikuar.”

2. Me e-mail datë 19.10.2022, znj. E.S i është komunikuar shkresa nr.7769/ 1 prot datë 22.09.2022. Pala ankuese nuk depozitoi në vijim kundërshtime në lidhje me qëndrimin e depozituar nga ana e Bashkisë Korçë.
3. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.” dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, nëpërmjet shkresës nr. 1205/3 Prot., datë 23.11.2022, Komisioneri njoftoi palët për realizimin e seancës dëgjimore në datën 06.12.2022. Seanca dëgjimore e datës 06.12.2022 nuk u realizua në datën e përcaktuar, dhe në vijim për t’u dhënë palëve kohën e nevojshme për t’u përgatitur nëpërmjet shkresës nr.1205/4 prot datë 21.12.2022, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore për në datën 16.01.2023.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 16.01.2023, në mungesë të palës ankuese, e cila megjithëse kishte dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të kësaj seance nuk u paraqit dhe nuk paraqiti ndonjë arsye për mungesën e prezencës. Në seancë dëgjimore u paraqit Bashkia Korçë, e përfaqësuar nga znj. Gj.P, sipas autorizimit nr.11010/1 prot datë 10.01.2023, të lëshuar nga kryetari i Bashkisë Korçë.

4. Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 447 prot datë 19.01.2023, Bashkia Korçë depozitoi sqarime në lidhje me vlerësimin e jetëshkrimit të dy kandidatëve për konkursin specialist në sektorin e informimit qytetar. Ndër të tjera në këtë shkresë Bashkia Korçë, parashtron se:

Vlerësimi i jetëshkrimit është kryer në përputhje me Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në

kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurimit të hapur”, Kreu III “Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive”.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidatja znj. L.S (Ç), ajo zotëron diplomën Master Profesional sipas kërkesave të shpalljes, pra në lidhje me vlerësimin e arsimit kandidatja është vlerësuar me 1 pikë për plotësimin e kërkesave, pasi nuk ka asnjë dokument tjetër i cili vërteton arsimin shtesë të mbaruar ose jo. Në lidhje me përvojën e lidhur me pozicionin sipas fotokopjes së librezës së punës, kandidatja nga data 28.09.2020 është e punësuar si specialiste e pritjes qytetare pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Korçë dhe është vlerësuar me 2 pikë për shkak të eksperiencës në punë lidhur me pozicionin deri në 1 vit, pasi në atë kohë nuk kishte plotësuar 2 vite eksperiencë në punë për t’u vlerësuar me 3 pikë. Në lidhje me trajnimin e lidhur me fushën është vlerësuar me 0 pikë, pasi nuk është dorëzuar asnjë certifikatë/trajnim në lidhje me fushën. Në total znj. L.S (Ç) është vlerësuar me 3 pikë nga 15 pikë në total.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga znj. E.S, ajo zotëron diplomën Master Profesional sipas kërkesave të shpalljes, pra në lidhje me vlerësimin e arsimit kandidatja është vlerësuar me 1 pikë për plotësimin e kërkesave, pasi nuk ka asnjë dokument tjetër i cili vërteton arsimin shtesë të mbaruar ose jo. Në lidhje me përvojën e lidhur me pozicionin nuk është dorëzuar librezë pune, por është dorëzuar një vertetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore në të cilin nuk është specifikuar subjekti dhe pozicioni në të cilin është punësuar. Gjithashtu, ka dorëzuar dy letra reference në gjuhën anglisht, të cilat duhet të ishin të përkthyer në gjuhën shqipe dhe një letër reference në lidhje me pjesmarrjen në një projekt. Sipas VKM nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësisive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, pika 6, “.....vite punë do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi...”. Në zbatim të VKM-së së sipërpërmendur, kandidatja është vlerësuar me 0 pikë për përvojën lidhur me pozicionin. Në lidhje me trajnimin e lidhur me fushën, kandidatja ka dorëzuar disa certifikata dhe trajnime të cilat nuk i përkasin fushës në të cilën është konkuruar (specialist në sektorin e informimit qytetar), për këtë arsye është vlerësuar me 0 pikë, pasi nuk është dorëzuar asnjë certifikatë/trajnim në lidhje me fushën, ashtu siç është përcaktuar dhe në udhëzim. Në total znj. E.S është vlerësuar me 1 pikë nga 15 pikë në total.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, znj. E.S është e datëlindjes 05.11.1995 dhe është banore në qytetin e Korcës. Ajo ka përfunduar

studimet e larta në degën “Gjuhë-Letërsi”, pranë Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, në Universitetin e Fan S.Noli, Korçë në vitin 2017, duke u pajisur me Diplomë Universitare Bachelor. Ankuesja zotëron gjithashtu Diplomë Marsër Profesional në “Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Lartë në “Gjuhë-Letërsi”, të fituar në vitin 2019, pranë të njëjtit universitet.

Nëpërmjet njoftimit nr.5985 prot datë 04.07.2022, Bashkia Korçë ka shpallur procedurat për 1 (një) vendin e lirë të punës në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin “Specialist në Sektorin e Informimit Qytetar në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimit Qytetar, kategoria e pagës III.b. Ankuesja ka aplikuar dhe ka dorëzuar dokumentacionin për këtë pozicion pune në shërbimin civil të shpallur nga Bashkia Korçë. Znj. S., është njoftuar se është kualifikuar për të marrë pjesë në fazën e testimit me shkrim për këtë konkurim, i cili është njoftuar se do të zhvillohej në datën 11.08.2022. Në përfundim të fazës së testimit me shkrim, znj. E.S është njoftuar nga Bashkia Korçë se kishte marrë 39.05 pikë në total në testimin me shkrim dhe se ishte kualifikuar për fazën e intervistës së strukturuar me gojë, e cila do të zhvillohej në datën 24.08.2022.

Znj. E.S, ka marrë pjesë në fazën e intervistës së strukturuar me gojë dhe në përfundim të kësaj faze, është njoftuar se nuk ishte përzgjedhur kandidat fitues me mbi 70 pikë (70% të pikëve) dhe se vlerësimi i saj në përfundim të procedurës së konkurimit ishte: 39.5 pikë nga 60 pikë në total në testimin me shkrim; 1 pikë nga 15 pikë në total nga vlerësimi i jetëshkrimit; 20 pikë nga 25 pikë në total nga intervista e strukturuar me gojë; duke grumbulluar në total një vlerësim prej 60.5 pikë nga 100 pikë në total.

Nga aktet e administruara rezulton se në procedurën e konkurimit kanë aplikuar gjithsej, së bashku me znj. E.S, katër kandidatë, prej të cilëve, një është skualifikuar në fazën e verifikimit paraprak për shkak të mungesës së dokumentacionit (kandidati nuk plotësonte nivelin minimal të diplomës së kërkuar); një kandidat është skualifikuar për shkak se në provimin me shkrim nuk ka marrë pikët e mjaftueshme për kualifikim në fazën e intervistës me gojë (ka marrë 15.5 pikë nga 60 pikë në total që është testimi me shkrim). Në njoftimin që i është bërë këtij kandidati, rezulton se Bashkia Korçë parashtron si arsye të skualifikimit të kandidatit, faktin që ai nuk ka marrë mbi 30 pikë në testimin me shkrim); dy kandidatët e tjerë, një prej të cilëve znj. S., kanë zhvilluar fazën e testimit me shkrim dhe intervistën e strukturuar me gojë, por asnjë prej tyre nuk ka marrë mbi 70 pikë dhe për këtë arsye Bashkia Korçë nuk ka përzgjedhur asnjë fitues për këtë procedurë konkurimi të zhvilluar.

Referuar raportit datë 26.08.2022, të Komitetit të Përhershëm të Pranimit, pranë Bashkisë Korçë, rezulton se, procedura ka përfunduar pa kandidat fitues, pasi asnjë nga kandidatët që i ishin nënshtruar fazës së vlerësimit nuk kishin arritur të merrnin mbi 70 pikë. Nga përmbajtja e këtij raporti rezulton se, në procedurën e konkurimit kanë marrë pjesë gjithsej 2 kandidatë, znj. L.S (Ç), e cila është vlerësuar në total me 65 pikë dhe znj. E.S e cila është vlerësuar në total me 60.5 pikë.

Në datën 27.08.2022, ankuesja ka paraqitur ankesë me shkrim në rrugë elektronike (*me email*) në lidhje me rezultatin e vlerësimit dhe mospërzgjedhjen e saj si kandidate fituese në procedurën e konkurimit. Me e-mail datë 29.08.2023, ankueses i është kthyer përgjigje se, në bazë të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe VKM nr.243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, ajo nuk ishte përzgjedhur si fituese, pasi kishte marrë më pak se 70 pikë (70 % të pikëve).

Znj. E.S ka depozituar zyrtarisht prane Bashkisë Korçë të njëjtin ankimim, protokolluar me nr.7347 prot datë 30.08.2022. Me shkresën nr.7347/1 prot datë 31.08.2022, Bashkia Korçë i ka kthyer përgjigje znj. S. se, pas shqyrtimit të ankesës së saj nga ana e Komitetit të Përhershëm të Pranimit të Shërbimit Civil, pikët përfundimtare mbeteshin 60.5 pikë nga 100 pikë në total.

Shoqata “Për Drejtësi Sociale” e autorizuar nga znj. E.S, ka depozituar në emrin e saj, ankesën nr. 128, datë 07.09.2022, duke pretenduar se znj. S. ishte diskriminuar për shkak të etnisë nga Bashkia Korçë, gjatë procedurës së ndjekur për marrjen në punë në pozicionin e lirë si nëpunës civil të shpallur nga ana e saj si “Specialist në Sektorin e Informimit Qytetar në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimit Qytetar”.

Në bazë të nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3, pika 2, të këtij ligji si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të LMD.

Në Kreun II, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD, në nenin 12/1/b, përcakton se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;*”.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se një person është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- personi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar personin në të drejtën për punësim, duke përfshirë këtu edhe momentin e rekrutimit dhe të përzgjedhjes për një vend të lirë pune;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;

- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një ose më shumë, nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga LMD.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga pala ankuese, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse znj. E.S i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm nga ana e punëdhënësit Bashkia Korçë, gjatë procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes për pozicionin e punës “Specialist në Sektorin e Informimit Qytetar në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimit Qytetar”.

Rezulton se, pozicioni i punës për të cilin ka konkuruar znj. E.S “*Specialist në Sektorin e Informimit Qytetar në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimit Qytetar*” është pjesë e shërbimit civil dhe procedurat e rekrutimit dhe përzgjedhjes së punëmarrësëve rregullohen në bazë të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunsin civil*”, i ndryshuar (në vijim ligji nr.152/2013) dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Në nenin 5, të ligjit nr.152/2013, ku parashikohen parimet e administrimit të shërbimit civil, përcaktohet se :“*Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil.*”

Procedurat e rekrutimit dhe përzgjedhja e fituesit për pozicionin e punës në të cilin ka aplikuar znj. E.S është pjesë e shërbimit civil, kategoria ekzekutive dhe rregullohet nëpërmjet Vendimit Nr.243, datë 18.03.2015 “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, të ndryshuar (në vijim VKM nr.243/18.03.2015) dhe Udhëzimit nr. 2, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurimit të hapur*”. (Udhëzimi i DAP nr.2/27.03.2015)

Pala ankuese pretendon se nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë gjatë fazave të konkurrimit dhe sipas saj procesi përzgjedhës i fituesit ka qenë fiktiv dhe i paracaktuar. Në këtë kontekst, pala ankuese pretendon se procedura e ndjekur nga ana e strukturës përkatëse të Bashkisë Korçë ka qenë në shkelje të ligjit dhe diskriminuese ndaj saj, për shkak të përkatësisë etnike.

Pretendimet e palës ankuese për shkelje të ligjit gjatë procedurës së zhvilluar konsistojnë në dy momente. *Së pari* ankuesja evidenton se, bazuar në VKM nr.243/18.03.2015, pika 11, e Kreut IV, vetëm kandidati i cili grumbullon mbi 45 pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë. Referuar vlerësimin që i është komunikuar znj. S., ajo është vlerësuar vetëm me 40.5 pikë në testimin me shkrim dhe vlerësimin e jetëshkrimit së bashku. Në këto kushte pala ankuese, ngre pretendimin se si është kualifikuar znj. S. për intervistën e strukturuar me gojë pa plotësuar pikët e nevojshme për të kaluar në fazën tjetër

të vlerësimit, sikurse është intervista e strukturuar me gojë. *Momenti i dytë* që ankuesja pretendon se ka patur shkelje të ligjit, ka të bëjë me pretendimet që ajo ngre për vlerësim të padrejtë të jetëshkrimit të saj me vetëm 1 pikë.

Në lidhje me shkeljen e parë të pretenduar nga pala ankuese, Komisioneri bazuar në faktet dhe provat e administruara si dhe kuadrit ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm konstaton dhe vlerëson si më poshtë:

Në Kreun IV “Konkurrimi”, të VKM nr. nr.243/18.03.2015, bëhen parashikimet e mëposhtme:

“7. Në vlerësimin e kandidatëve, përfshihen:

- a) vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;*
- b) vlerësimi me shkrim;*
- c) intervista e strukturuar me gojë.*

8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;*
- b) për intervistën e strukturuar me gojë, deri në 25 pikë;*
- c) për vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë*

9/1. Nëse kandidati grumbullon më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë) nga vlerësimi me shkrim, ai kualifikohet për të kaluar në procesin e vlerësimit të jetëshkrimit. (shtuar me VKM nr.746, datë 19.12.2018)

11. Nëse kandidati grumbullon mbi 45 pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë. (ndryshuar me VKM nr.746, datë 19.12.2018)

12. KPP-ja, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, liston kandidatët fitues me mbi 70 pikë (mbi 70 % të pikëve), duke filluar nga kandidati me rezultatin më të lartë. Lista me renditjen e kandidatëve sipas pikëve, i dërgohet nga KKP njësisë përgjegjëse brenda 24 (njëzetëkatër) orëve nga përpilimi i saj.

15. Kandidatët, që kanë marrë më pak se 70 pikë (70% të pikëve), renditen në një listë të posaçme që nuk bëhet publike dhe ata njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse.

20. Nëse asnjë nga kandidatët nuk merr mbi 70 pikë (70% të pikëve), atëherë komiteti vendos përfundimin e fazës së vlerësimit të kandidatëve pa asnjë të përzgjedhur fitues. Njësia përgjegjëse bën njoftimin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, për përfundimin e konkurrimit pa asnjë fitues.”

Rezulton se para ndryshimeve që janë bërë nëpërmjet VKM nr.746, datë 19.12.2018, VKM nr.243/18.03.2015, në pikën 11 të saj ka patur këtë formulim: *“11. Nëse kandidati grumbullon më*

shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë) nga vlerësimi me shkrim, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë dhe vlerësimin e jetëshkrimit”

Në Udhëzimin e DAP nr.2/27.03.2015, bëhen parashikimet e mëposhme:

“II/4 “PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE”

6. Kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistën e strukturuar me gojë kandidatët të cilët kanë grumbulluar në vlerësimin me shkrim më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë)

9. KPP bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve të marra në secilën fazë të vlerësimit dhe ato në total në përfundim të vlerësimit.

10. Në fund të procedurës së vlerësimit kandidati nuk konsiderohet fitues nëse nuk ka marrë mbi 70 pikë (mbi 70% të pikëve)

III/7 VLERËSIMI I JETËSHKRIMIT, PËRGATITJA PËR INTERVISTËN E STRUKTURUAR ME GOJË, VLERËSIMI I INTERVISTËS SË STRUKTURUAR ME GOJË

1. Pikët totale për vlerësimin e jetëshkrimit janë 15 dhe ndahen si vijon:

a) deri në 5 pikë për vlerësimin e arsimit të lidhur me pozicionin:

- 1 pikë për plotësimin e kërkesave;
- 2 pikë për tejkallim të lehtë të kërkesave – arsimim shtesë (pa mbaruar);
- 3 pikë për tejkallim të kërkesave – arsimim shtesë (e mbaruar) ose diplomë shtesë;
- 5 pikë për tejkallim domethënës të kërkesave - gradë arsimore shtesë (e mbaruar) ose diplomë shtesë në fushën që është veçanërisht e rëndësishme për institucionin.

b) deri në 5 pikë për përvojën e lidhur me pozicionin:

- 1 pikë për plotësimin e kërkesave;
- 2 pikë për tejkallim të lehtë të kërkesave - deri në 1 vit eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar;
- 3 pikë për tejkallim të kërkesave - nga 1-3 vite eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar, ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar;
- 5 pikë për tejkallim domethënës të kërkesave - më shumë se 3 vjet eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar, ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar.

c) deri në 5 pikë për trajnimin e lidhur me fushën:

- 1 pikë për plotësimin e kërkesave;
- 2 pikë për tejkallim të kërkesave - 1-3 trajnime shtesë;
- 5 pikë për tejkallim domethënës të kërkesave - më shumë se 3 trajnime shtesë.

2. Pikët për çdo element (arsimimin, përvojën e trajnimit) mblidhen. Pikët në total mblidhen dhe pjesëtohen me 5, duke i rrumbullakosur deri në një presje dhjetore.

Nga verifikimi i realizuar në faqen zyrtare të DAP, rezulton se udhëzimi nr.2, datë 27.03.2015, nuk rezulton që të ketë pësuar ndryshime të mëvonshme. Sa më sipër rezulton se, nuk janë reflektuar në këtë udhëzim amendimet që ka pësuar VKM nr.243/18.03.2015 dhe që ndryshojnë disa nga kushtet që kandidatët në konkurim duhet të plotësojnë për të vijuar në fazat vijuese të konkurimit.

Znj. E.S është vlerësuar në testimin me shkrim me 39.5 pikë nga 60 në total. Bazuar në pikët që ajo ka grumbulluar në fazën e testimit me shkrim ajo është njoftuar se kualifikohet për fazën e radhës, atë të intervistës së strukturuar me gojë. Në njoftimin që i është bërë nga Bashkia Korçë nuk gjen pasqyrim vlerësimi i jetëshkrimit.

Të njëjtën praktikë Bashkia Korçë ka ndjekur edhe me kandidaten tjetër znj.L.S (Ç). Kjo candidate ka fituar në testimin me shkrim 42 pikë nga 60 në total. Bazuar në pikët që ajo ka grumbulluar në fazën e testimit me shkrim, është njoftuar se kualifikohet për fazën e radhës, atë të intervistës së strukturuar me gojë. Në njoftimin që i është bërë nga Bashkia Korçë nuk gjen pasqyrim vlerësimi i jetëshkrimit edhe për këtë candidate.

Nga aktet e vendosura në dispozicion nga Bashkia Korçë konstatohet se, edhe në njoftimin që i është bërë kandidatit që është skualifikuar për të vijuar me fazën e intervistës së strukturuar me gojë për shkak se ka marrë vetëm 15.5 pikë në testimin me shkrim, Bashkia Korçë parashtron se arsyeja e moskalimit në fazën vijuese është fakti se ky aplikant nuk ka marrë 30 pikë në testimin me shkrim.

Bazuar në konstatimet e mësipërme Komisioneri gjykon se, gjatë procedurës së ndjekur Bashkia Korçë i është referuar udhëzimit nr.2, datë 27.03.2015 të DAP, ku shprehimisht parashikohet se, “Kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistën e strukturuar me gojë kandidatët të cilët kanë grumbulluar në vlerësimin me shkrim më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë)”. Në vlerësimin e Komisionerit, Bashkia Korçë ka zbatuar në mënyrë të gabuar procedurën e parashikuar nga VKM nr.243/2015, ndryshuar me VKM nr.746/2018, ku shprehimisht parashikohet : “Nëse kandidati grumbullon mbi 45 pikë nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë.”

Bazuar në vlerësimin e kryer nga Bashkia Korçë për znj. E.S, ajo ka grumbulluar 39.5 pikë në testimin me shkrim dhe 1 pikë është vlerësuar për jetëshkrimin, pra në total 40.5 pikë. Në këto kushte ajo nuk duhet të ishte kualifikuar për fazën e intervistës së strukturuar me gojë, pasi për të kaluar në fazën e intervistës së strukturuar me gojë, ajo duhet të kishte fituar nga testimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, 46 pikë ose më shumë ndërsa ajo është vlerësuar me vetëm 40.5 pikë.

Bazuar në vlerësimin e kryer nga Bashkia Korçë për kandidaten tjetër znj.L.S (Ç), ajo ka grumbulluar 42 pikë në testimin me shkrim dhe 3 pikë është vlerësuar për jetëshkrimin, pra në total 45 pikë. Në këto kushte edhe kjo kandidate nuk duhet të ishte kualifikuar për fazën e intervistës së strukturuar me gojë, pasi për të kaluar në fazën e intervistës së strukturuar me gojë, ajo duhet të kishte fituar nga testi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, 46 pikë ose më shumë, ndërsa ajo është vlerësuar me 45 pikë.

Sa më sipër, rezulton se, pavarësisht se Bashkia Korçë nuk ka zbatuar drejtë procedurën e parashikuar në VKM nr.243/2015, të ndryshuar me VKM nr.746/2018, ajo e ka zbatuar atë njësoj, si për znj. E.S ashtu dhe për kandidaten znj. L.S (Ç). Zbatimi jo korrekt VKM përkatëse, në thelb ka favorizuar të dy kandidatët si znj. S. ashtu edhe znj. L.S (Ç) duke i kualifikuar në fazën vijuese të konkurimit atë të intervistës së strukturuar me gojë, ndërkohë që duhet ta kishte mbyllur procedurën pasi asnjë nga kandidatët nuk kualifikohej në fazën e intervistës së strukturuar me gojë. Gjithashtu, duke u bazuar në tërësinë e procedurës së ndjekur nga Bashkia Korçë në pamje të parë krijohet përshtyrja se zbatimi i gabuar i VKM nr.243/2015, ndryshuar me VKM nr.746/2016, ka ardhur si rezultat i referimit në udhëzimin e DAP Nr.2/27.03.2015, i cili nuk rezulton që të jetë amenduar pas ndryshime që ka pësuar VKM nr.243/2015.

Në lidhje me pretendimin e dytë që pala ankuese ngre mbi vlerësimin e padrejtë me vetëm 1 pikë të jetëshkrimit të znj. E.S, bazuar në aktet e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës rezulton se:

Pala ankuese, nuk parashtrohet ndonjë pretendim konkret se në cilin prej kriterëve ku bazohet vlerësimi i jetëshkrimit apo cili dokumentacion që ajo ka paraqitur për të përligjur përmbushjen e kërkesave, nuk është vlerësuar drejtë gjatë procedurës së vlerësimit. Në ankesën që znj. S. ka paraqitur pranë bashkisë Korçë ajo shprehet se nuk është dakort me vlerësimin në lidhje me arsimin, pasi tek njoftimi punës nuk është specifikuar fusha specifike e arsimit por është thjesht diploma në kategorinë e shkencave sociale.

Referuar shpalljes së realizuar nga Bashkia Korçë për pozicionin e punës për të cilin është zhvilluar procedura e konkurimit rezulton se, kandidatët duhet të plotësojnë kriterin e veçantë si vijon: *“Të zotërojnë nivelin minimal të diplomës “Master Profesional”*.

Referuar VKM nr.243/2015, të ndryshuar, vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e 3 kriterëve, arsimimit, përvojës dhe të trajnimeve, të lidhura me fushën. Pikët totale për vlerësimin e jetëshkrimit janë 15. Sipas, Udhëzimit të DAP nr.2, datë 27.03.2015, ndarja e pikëve të vlerësimit të jetëshkrimit për kriterin e arsimit është deri në 5 pikë nga ku: 1 pikë për plotësimin e kërkesave; 2 pikë për tejkallim të lehtë të kërkesave – arsim shtesë (pa mbaruar); 3 pikë për tejkallim të kërkesave – arsim shtesë (e mbaruar) ose me diplomë dhe 5 pikë për tejkallim domethënës të kërkesave – gradë arsimore shtesë (e mbaruar) ose diplomë shtesë në fushën që është veçanërisht e rëndësishme për institucionin.

Rezulton se, për vlerësimin e arsimit, znj. S. është vlerësuar me 1 pikë, pasi ajo nuk rezulton që të ketë arsim shtesë të pambaruar apo të mbaruar ose ndonjë diplomë shtesë. Në bazë të parashikimeve të mësipërme, konstatohet se, ajo është vlerësuar drejtë në lidhje me këtë kriter të vlerësimit të jetëshkrimit.

Pjesë e vlerësimit të jetëshkrimit, është edhe përvoja në punë. Sipas, Udhëzimit të DAP nr.2, datë 27.03.2015, ndarja e pikëve të vlerësimit të jetëshkrimit për kriterin e përvojës në punë është deri në 5 pikë nga ku: 1 pikë për plotësimin e kërkesave; 2 pikë për tejkalim të lehtë të kërkesave – deri në 1 vit eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur më pozicionin, por që nuk është kërkuar; 3 pikë për tejkalim të kërkesave - nga 1-3 vite eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar, ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur më pozicionin, por që nuk është kërkuar; 5 pikë për tejkalim domethënës të kërkesave - më shumë se 3 vjet eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar, ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur më pozicionin, por që nuk është kërkuar.

Referuar shpalljes së realizuar nga Bashkia Korçë për pozicionin e punës për të cilin është zhvilluar procedura e konkurimit rezulton se, nuk ka patur kritere të veçanta në lidhje me eksperiencën në punë.

Sipas shpjegimeve të dhëna nga Bashkia Korçë, rezulton se znj. S. është vlerësuar me 0 pikë në lidhje me përvojën lidhur me pozicionin, pasi nuk është dorëzuar librezë e punës por një vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në të cilin nuk është specifikuar subjekti dhe pozicioni në të cilin është punësuar si dhe dy letra reference në gjuhën angleze, të cilat duhet të ishin depozituar të përkthyer në gjuhën shqipe dhe një letër reference për pjesmarrjen në një projekt. Sipas Bashkisë Korçë, znj. S. për të provuar përvojën lidhur me pozicionin duhet të kishte depozituar librezën e punës, pasi në referim të VKM nr.165, datë 02.03.2016 *“Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të vetëqeverisjes vendore”*, i ndryshuar, pika 6, *“.....vite punë do të konsiderohen vjetërsia e përgjithshme në punë e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi....”*. Në zbatim të VKM-së së sipërpërmendur, kandidatja është vlerësuar me 0 pikë për përvojën lidhur me pozicionin.

Nga aktet e administruara rezulton se, znj. E.S nuk ka depozituar kopje të librezës së punës për të provuar përvojën në punë të pasqyruar në jetëshkrimin e saj.

Referuar vërtetimit për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për individin –E-SIG 03/a), nr.T06498359 datë 13.07.2022, të Drejtorisë Rajonale të tatimeve Korçë, rezulton se znj. S. është deklaruar nga subjekti Zyra Vendore Arsimore Korçë-Pustec. Për periudhën janar – qershor 2021 në emër të saj nga ky subjekt janë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore shëndetësore e shoqërore, ndërsa për periudhën korrik 2021 – qershor 2022, znj. S. rezulton vetëm si e deklaruar. Nuk rezultojnë akte të tjera që të tregojnë se në çfarë pozicioni pune ka punuar ajo pranë subjektit ZVA Korçë – Pustec, i cili ka derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Në jetëshkrimin e depozituar nga ana e ankueses, ajo deklaron se gjatë periudhës 2018-2021 ka punuar si mësuese pranë Shkollës 9-vjeçare “Ismail Qemali” Korçë dhe pranë Shkollës së Mesme “Faik Konica” Korçë; gjatë periudhës 2021-2022, si aktiviste e ligjit dhe informimit qytetar pranë shoqatës “Unë Gruaja”; ndërsa gjatë periudhës janar 2021 – korrik 2021, si gazetare investigative për qytetin e Korçës tek Informimi.al, prej të cilit është larguar për shkak të shtatzanisë dhe lindjes së fëmijës në muajin gusht. Në CV-në e znj. S. pasqyrohet gjithashtu se, në periudhën korrik 2020-qershor 2021, ajo ka punuar si mentore për grupin e Rinisë në Rajonin e Korçës “OSFA”. Rezulton se, eksperiencat e deklaruara nga ankuesja në jetëshkrimin e saj (CV) nuk shoqërohen me dokumentacionin përkatës provues.

Bazuar në kriteret ligjore të vlerësimit të përvojës lidhur me pozicionin si dhe dokumentacionit të dorëzuar gjatë aplikimit për konkurim në pozicionin e pretenduar, Komisioneri vlerëson të drejtë dhe të bazuar vlerësimin e bërë nga Bashkia Korçë me 0 pikë në lidhje me këtë kriter.

Pjesë e vlerësimit të jetëshkrimit, janë edhe trajnimet që kandidati që lidhen me fushën përkatëse. Sipas, Udhëzimit të DAP nr.2, datë 27.03.2015, ndarja e pikëve të vlerësimit të jetëshkrimit për trajnimin e lidhur me fushën është deri në 5 pikë nga ku: 1 pikë për plotësimin e kërkesave; 2 pikë për tejkalim të kërkesave, 1-3 trajnime shtesë; 5 pikë për tejkalim domethënës të kërkesave, më shumë se 3 trajnime shtesë.

Referuar shpalljes së realizuar nga Bashkia Korçë për pozicionin e punës për të cilin është zhvilluar procedura e konkurimit rezulton se, nuk ka patur kriteret të veçanta në lidhje me trajnimet e lidhura me fushën.

Bazuar në dokumentacionin që znj. E.S ka depozituar gjatë aplikimit dhe që u administruan gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se, ajo ka depozituar disa certifikata dhe trajnime, të cilat kryesisht të njohjes së gjuhës angleze, aftësive në fushën e IT, apo në lidhje me tema si, menaxhim projekti, shkrim akademik, advokim në media, multimedia dhe aktivizmi. Komisioneri nuk mund të marrë rolin dhe atributet e KPP dhe të vlerësojë në lidhje me natyrën e trajnimeve me fushën përkatëse, por në pamje të parë dokumentacioni i depozituar nga ankuesja nuk ngre dyshime për një vlerësim të gabuar të kriterit që lidhet me trajnimet e fushës, në lidhje me pozicionin specialist në sektorin e informimit qytetar. Por edhe nëse ankuesja do të duhet të ishte vlerësuar edhe me maksimumin e pikëve që parashikohen për kriterin e trajnimeve në fushën përkatëse, sipas kërkesave ligjore të VKM nr.243/2015, i ndryshuar, ligjerisht ajo nuk mund të kalonte në fazën vijuese, atë të intervistës së strukturuar me gojë. Ankuesja ka kaluar në mënyrë të parregullt në fazën e intervistës së strukturuar me gojë, në të cilën është vlerësuar me 20 pikë.

Nga aktet e administruara, rezulton se, Bashkia Korçë ka vlerësuar jetëshkrimin e kandidatës L.S (Ç) me 3 pikë gjithsej, nga të cilat 1 pikë në lidhje me vlerësimin e arsimit dhe 2 pikë për përvojën në punë. Nga aktet e administruara rezulton se kjo candidate ka të njëjtin nivel diplome “Master profesional” sikurse znj. S. dhe në të njëjtën fushë atë të gjuhë letërsisë dhe në Arsimin e Mesëm të Lartë. Rezulton se kjo candidate, referuar librezës së punës të depozituar gjatë aplikimit, është e

punësuar pranë ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Korçë, që prej datës 28 shtator 2020. Kandidatja L.S (Ç) është vlerësuar me 0 pikë për kriterin e trajnimeve në fushën përkatëse pasi nuk ka depozituar asnjë certifikatë/trajnim në lidhje me fushën.

Përfundimisht Komisioneri nuk konstaton se znj. E.S është vlerësuar në mënyrë të padrejtë për sa i përket jetëshkrimit të saj, pavarësisht se ky vlerësim ka qenë me 1 pikë. Në këto kushte, pavarësisht se Bashkia Korçë nuk ka zbatuar drejt procedurën e VKM nr.243/2015, të ndryshuar duke e kualifikuar znj. E.S për në fazën e intervistës së strukturuar me gojë edhe pse ajo nuk kishte fituar pikët e mjaftueshme, kjo paligjshmëri nuk e ekspozon ankuesen ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë. Rezulton se ankuesja është trajtuar njësoj me kandidatët e tjerë dhe në përfundim të procedurës nuk ka patur asnjë kandidat fitues.

Bazuar në tërësinë e arsytimit të mëmsipërm si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, znj. E.S, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Bashkisë Korçë, gjatë procedurës së konkurimit për pozicionin e punës “*Specialist në Sektorin e Informimit Qytetar në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimit Qytetar*”. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, nga ana e subjektit kundër të cilit pala ankuese ka paraqitur ankesën, Bashkia Korçë.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. E.S, në të drejtën për punësim, për shkak të etnisë, nga ana e Bashkisë Korçë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Etnia
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim